

# PLANIFIKIMI I USHQYERJES NË INSTITUCIONET E KUJDESIT DITOR TË FOSHNJEVERE DHE FËMIJËVE (6 MUAJ - 6 VJEÇ) NË REPUBLIKËN E KOSOVËS



Ky udhëzues u hartua me mbështetjen financiare të  
UNICEF Zyra në Kosovë

Dizajni: shortcutmedia.net  
Janar, 2021



# PËRMBAJTJA

Hyrje	5
Zhvillimi dhe udhëzimet për planifikimin e ushqyerjes në institucionet e kujdesit ditor të fëmijëve	6
Ushqyerja në moshën e fëmijërisë	8
Pikat kyçe të hartimit të menisë	8
Modeli i vakteve	9
Parimet e zgjedhjes dhe kombinimit të ushqimeve	10
Nevojat ushqimore për fëmijë	11
Nevojat ushqimore të fëmijëve në institucionet e kujdesit ditor	12
Mosha 6-12 muaj Fillimi i ushqimit solid – krahas qumështit të gjirit ose formulës	13
Zhvillimi i foshnjes dhe ushqimet e rekomanduara Mosha mbi 2 vjeç	14
Sasia e ushqimit sipas vaktit, moshës, grupit të ushqimit	16
Kriteret për një menu të ushqyeshme	17
Kriteret për një mjedis të shëndetshëm të ushqyerit	18
Parimet e ushqyerjes së shëndetshme për fëmijët e moshës 6 muaj – 3 vjeç	19
Përcaktimi i cilësisë së ushqimit	20
Menutë javore të foshnjave sipas grupmoshave për stinët (vjeshtë-dimër)	21
Menutë javore të foshnjave sipas grupmoshave për stinët (pranverë-verë)	22
Udhëzues për alternativat e vakteve për moshën 1-6 vjeç	24
Menutë javore për moshën 1-6 vjeç, për dy stinë	25
Receta dhe përgatitja e ushqimit	33
Pjata kryesore	34
Sallata	40
Supa	40
Ëmbëlsira	42
Përgatitja dhe servirja e ushqimeve	43
Bibliografia	46

# HYRJE

Ushqyerja e shëndetshme gjatë fëmijërisë së hershme është faktor vendimtar për rritjen dhe shëndetin e fëmijëve. Ushqimi i varfër në vlera ushqyese në fëmijëri ka pasoja afatgjata në shëndetin e njeriut dhe është i lidhur me sëmundje kronike në moshë të rritur. Për më tepër, mungesat e elementeve mikroushqyese si hekuri dhe jodi lidhen me çrregullime psikomotorë dhe konjitive, si dhe me pjesëmarrje të ulët në aktivitetet sociale. Institucionet parashkollë duhet të ofrojnë ushqim të shëndetshëm për fëmijët, në mënyrë që të mbështesin rritjen e shëndetshme dhe zhvillimin psikomotorik të fëmijëve. Është shumë e rëndësishme që menutë që ofrojnë institucionet parashkollë të jenë të hartuara nga profesionistë të fushës bazuar në përlogaritje të vlerave ushqyese të nevojshme që duhet të marrin fëmijët gjatë kohës që qëndrojnë aty. Udhëzuesi "Planifikimi i të ushqyerit për institucionet e kujdesit ditor të foshnjave dhe fëmijëve (6 muaj – 6 vjeç) në Republikën e Kosovës" ka për qëllim krijimin dhe integrimin e një mjedisi në sistemin parashkollor që promovon ushqyerjen e shëndetshme tek fëmijët dhe shprehitë e shëndetshme me qëllim të arritjes së potencialit të plotë të fëmijëve. Udhëzuesi ofron informatat kyçe mbi rëndësinë dhe parimet e ushqyerjes së drejtë për moshat 6 muaj deri 6 vjeç; nevojat për ushqyerje të fëmijëve në institucionet e kujdesit ditor; kriteret për një mjedis të shëndetshëm të ushqyerit; parimet e ushqyerjes së shëndetshme të ndara sipas grupmoshave të caktuara; menu konkrete për grupmosha të caktuara dhe të ndara sipas stinëve; udhëzime konkrete për mënyrën e përgatitjes së recetave të paraqitura në menu, etj. Ky udhëzues është në harmoni të plotë me "Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr. 03/2019 për të Ushqyerit e Shëndetshëm të Fëmijëve në Institucionet Edukative Arsimore Aftësuese të Arsimit Parauniversitar" dhe "Standardet e Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjeç (MASHT)".



Ky udhëzues u hartua nga Grupi Multisektorial për Ushqyerjen e Shëndetshme i përbërë nga përfaqësues të: Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës; Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës; Qendrës Klinike Universitare të Kosovës; Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës; Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës; Kolegjiumit të Drejtorëve të Institucioneve Parashkollë të Kosovës; Drejtorisë Komunale për Arsim në Prishtinë; Kuzhinës Qendrore Prishtinë, UNICEF-it Zyra në Kosovë, organizatës Aksioni për Nënë dhe Fëmijë dhe nga MSc. Blerina Bombaj, dietologe klinike.

Projekti në kuadër të cilit është hartuar ky udhëzues është mbështetur nga UNICEF Zyra në Kosovë dhe është koordinuar nga fondacioni Aksioni për Nënë dhe Fëmijë.

# ZHVILLIMI DHE UDHËZIMET E PLANIFIKIMIT TË USHQYERJES NË INSTITUCIONET E KUJDESIT TË FËMIJËVE

## Baza teorike mbi te cilën është ngritur hartimi i menuve

Zakonet e varfra të ushqyerjes renditen ndër faktorët kryesorë të ndryshueshem të rrezikut për shfaqjen e sëmundjeve kronike jo të transmetueshme, si sëmundjet e zemrës, diabetit tip 2, ishemive dhe disa llojeve të sëmundjeve neoplazike (Seward K, 2017).

Për fëmijët, ushqyerja optimale është thelbësore në mbështetjen e rritjes së shëndetshme dhe zhvillimit të tyre. Veçanërisht viti i dytë dhe i tretë konsiderohen tepër të rëndësishëm dhe kritik në zhvillimin fiziologjik dhe mendor për shkak të rritjes së shpejtë dhe sistemit imunitar të pamaturuar plotësisht (Australian Dietary Guidelines, 2013). Për më tepër, zakonet e të ushqyerit, modelet dietetike dhe preferencat ushqimore që zhvillohen në fëmijëri ndiqen edhe në moshë të rritur duke mundësuar kështu parandalimin e mundshëm të shfaqjes dhe zhvillimit të sëmundjeve kronike (WHO, 2014).

Menutë në institucionet parashkollore duhet të hartohen mirë në mënyrë që të përfshijnë vakte dhe mesvakte të ushqyeshme, të nevojshme për një shëndet të mirë, rritje të plotë dhe zakone të shëndetshme të ushqyerjes që zgjasin gjatë të gjithë jetës (Mann L, 2013). Prindërit e fëmijëve që frekuentojnë institucionet e kujdesit ditor bazohen në këto qendra për mirëushqyerjen e fëmijëve të tyre, si nga sasia e bollshme, ashtu edhe nga cilësia e ushqimeve, por edhe për përcjelljen e edukimit të duhur ushqimor tek të vegjlit. Kjo është një mundësi e artë e çerdheve dhe kopshteve që të ndikojnë pozitivisht dhe për të gjithë jetën tek brezi i ri sa i takon mënyrës së të ushqyerit si një pjesë mjaft e rëndësishme e stilit të jetesës. Fëmijët që frekuentojnë çerdhet dhe kopshtet konsumojnë pothuaj 2/3 e ushqimit ditor të nevojshëm për ta. Për këtë arsye, këto institucione kanë potencialin ta përmirësojnë të ushqyerit e fëmijëve (Mann L, 2013).

Mirëpo përmbushja e këtyre objektivave është provuar se nuk është e lehtë. Zhvillimi i strategjive që synojnë në suksesin e zbatimit të këtyre menuve që përkojnë me udhëzimet ndërkombëtare mbi të ushqyerit kërkon një vlerësim më të hollësishëm të faktorëve që mund të përbëjnë pengesë ose ndihmë në zbatimin e udhëzimeve (Murphy PS, 2011).

## Procesi i punës ka përfshirë:

- Studimin e të dhënave vendore në dispozicion sa i përket popullatës së synuar, të dhënave demografike, antropometrike, dietetike, shëndetësore, socio-ekonomike dhe kulturore.
- Studimin e qasjes në ushqime, përballueshmërinë dhe gjendjen në dispozicion, preferencat e fëmijëve, infrastrukturën e qendrave të kujdesit, recetat tradicionale dhe aftësimin profesional të personelit të punësuar në kuzhinat e çerdheve dhe kopshteve, identifikimin e faktorëve jofavorizues për zbatimin e menuve, përfshirjen e ushqimeve dhe recetave të reja. Identifikimi i lehtësive apo strategjive që mund ta bëjnë më të lehtë zbatimin e udhëzimeve për menutë e ushqyerjes (trajnimi i personelit, udhëzues me shkrim, udhëzime për “ushqimin me vete”, angazhimin e prindërve dhe përvoja mësimore mbi ushqyerjen e shëndetshme).
- Referimin në politikat e vendeve të tjera evropiane lidhur me ushqyerjen në çerdhe dhe kopshte.
- Përcaktimin e grupmoshave dhe nevojave specifike për energji dhe lëndë ushqyese, përkatësisht (6 muaj – 1 vjeç; 1 – 3 vjeç; 4 – 6 vjeç) (Linou A, 2014).

## Planifikimi ushqimor dhe çështje që janë marrë në konsideratë:

- o Zhvillimi i një menuje të qëndrueshme (Springmann M, 2018) që përmbush standartet ushqimore aktuale, bazuar në “Dietary Reference Values” (EFSA, 2017) (WHO, 2014), me qëllim arritjen e të paktën 70% të Daily Reference Intake (DRIs), duke siguruar marrjen e mjaftueshme të energjisë dhe lëndëve ushqyese specifike me prioritet mangësi specifike ushqimore që përbëjnë shqetësim për shëndetin e secilës grupmoshë dhe promovimi i zakoneve të shëndetshme të të ushqyerit që trajtojnë shkallën e përhapur të rritjes së obezitetit (Benjamin SE, 2008).
  - o Përcaktimi i modelit të kërkuar për çdo vakt sa i përket grupeve të ushqimeve dhe cilësisë së tyre (p.sh., i freskët, i ngrirë, integral, me yndyrë të reduktuar etj.)
  - o Përshtatja e sasisë së racioneve sipas grupmoshës.
  - o Menu e përshtatur sipas traditës, sezonalitetit, kostos ekonomike, gjendjes në dispozicion, preferencave të fëmijëve, faktorëve fetarë dhe kulturorë.
  - o Përkujdesje për të futur ushqime të reja në formë tërheqëse, për të zhvilluar zakone të shëndetshme duke ofruar zgjedhje dhe fleksibilitet.
  - o Plotësimi i recetave të hollësishme të gatimit me udhëzime mbi teknikën e përgatitjes e ushqimve nga një shef kuzhine me përvojë të gjatë në gatimim e shëndetshëm.
- Zhvillimi i trajnimeve për personelin e institucioneve parashkollore, përfshirë edukatorët dhe personelin e kuzhinës, mbi përgatitjen e ushqimit dhe sigurinë ushqimore gjatë të gjithë procesit.
  - Hartimi i udhëzimeve dhe këshillave për “ushqimin me vete” në shkollë.

## Pritshmëritë

- Rritje dhe zhvillim i shëndetshëm i foshnjeve dhe fëmijëve nëpërmjet marrjes së mjaftueshme të ushqimit dhe lëndëve ushqyese.
- Përtimi i zakoneve të shëndetshme të të ushqyerit që mbështesin mirëqenien dhe shëndetin dhe parandalojnë sëmundjet kronike.
- Përmirësim i shëndetit individual dhe publik dhe ulje e kostove të sistemit shëndetësor, bazuar në rolin e jashtëzakonshëm të ushqimit në shëndetin dhe mirëqenien e individëve, shoqërisë dhe mjedisit.

## USHQIMI NË MOSHËN E FËMIJËRISË

Ushqimi optimal në moshën e fëmijërisë është ndër faktorët vendimtarë në mbarëvajtjen e rritjes, zhvillimit dhe shëndetit të tij. Praktikrat e duhura të të yshqyerit mund ta parandalojnë kequshqyerjen dhe rritjen e vonuar, fakt i dukshëm ky në disa vende të Evropës, të mbikëqyrura nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Fëmijët që ushqehen në mënyrë të varfër sa i përket përbërjes në lëndë ushqyese shfaqin më shpesh dhe në rrugë më serioze infeksione intestinale dhe vdekshmëri të lartë. Ushqimi në fëmijëri ka pasoja afatgjata në shëndetin e njeriut dhe ekzistojnë të dhëna bindëse se është i lidhur me sëmundje kronike në moshë të rritur. Për më tepër, mungesat në elemente mikroushqyese, si hekuri dhe jodi, lidhen me çrregullime psiko-motore dhe knjitive, si dhe me pjesëmarrje të ulët në aktivitetet sociale. Për këtë arsye, përmirësimi i ushqimit në kopshte dhe çerdhe ndikon drejtpërdrejtë në rritjen, zhvillimin dhe shëndetin e fëmijëve, në uljen e rrezikut të infeksioneve, si dhe favorizon maksimizimin e zhvillimit psiko-motor dhe të performancës në shkollë në afat të gjatë kohor.



## PIKAT KYÇE TË HARTIMIT TË MENUSË

Institucionet që ofrojnë ushqim për fëmijë duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë praktikave që sigurojnë ushqime kalorike pa cenuar dendësinë në lëndë mikroushqyese. Në hartimin e menuve të mëposhtme i është kushtuar rëndësi e veçantë:

- marrjes së mjaftueshme të energjisë, proteinave dhe përbërjes optimale të tyre në aminoacide esenciale;
- marrjes së mjaftueshme të hekurit, vitaminës A, C, kalciumit, zinkut;
- marrjes së yndyrnave cilësore, si acidet lyrore me lidhje të pangopur nga vaji i ullirit;
- marrjes së mjaftueshme të fibrave bimore prej drithërave me krunde dhe legumeve (bishtajave);
- kufizimit të yndyrnave të ngurta, si: margarina, dhjami, gjalpi;
- kufizimit të sheqerit dhe kripës;
- zgjedhjes së ushqimit sipas stinës;
- përzgjedhjes së kujdesshme të lëndës së parë, veçanërisht vajit të ullirit, bukës, qumështit, vezës dhe mishit;
- mënyrës së përgatitjes dhe servirjes së ushqimit, në mënyrë të përshtatshme sipas moshës;
- rritjes së konsumit të fibrave bimore nga buka e thekrës, perimet, frutat dhe legumet.

## MODELI I VAKTEVE

### MËNGJESI

Vakti i mëngjesit ofron 1 porcion\* drithëra (disa ditë të javës drithëra të plota si tërshëra dhe buka e thekrës); 1 porcion proteina (nga veza ose djathi); 1 porcion bulmet (qumësht ose kos); ½-1 porcion frut.

*"Fëmijët duhet të konsumojnë një mëngjes kalorik dhe ushqyes. Një mëngjes i varfër ose i munguar duket se lidhet me shfaqje të mbipeshës dhe obezitetit".*

### DREKA

Vakti i drekës ofron 1 porcion perime (me kombinim të 2-3 ngjyrave me prioritet ngjyrat jeshile dhe portokalli); 1-2 porcione proteina nga mishi ose legumet (perimet bishtajore); 1-2 porcione drithëra (gjysmë integrale, si buka e thekrës, bizelet ose fasulet); 1 porcion yndyrë nga vaji i ullirit. Pas konsumimit të drekës duhet të kalojnë së paku 30 minuta e pastaj të vendosen fëmijët në gjumë.

### ZAMRA

Vakti i pasdrekës përbëhet nga ½-1 porcion qumësht; ½-1 porcion frut ose lëng frutash të shtrydhur të holluar me ujë (kryesisht i pasur në vitamine A si pjeperi, ose C si portokalli); 1 porcion drithëra; ½-1 porcion proteina (si veza, gjiza ose djathi).

*\*porcionet për fëmijë llogariten ndryshe në krahasim me të rriturit dhe janë më të vogla.*



## PARIMET E ZGJEDHJES DHE KOMBINIMIT TË USHQIMEVE

- Në menunë e moshave 1-3 dhe 4-6 vjeç, vendosja e ushqimeve ndjek parimin e servirjes së ushqimeve të dukshme, me copëza të vogla dhe të ndara nga njëra-tjetra, në mënyrë që fëmija t'i dallojë shijet dhe të zgjedhë atë që i pëlqen. Fëmijët pëlqejnë shije të pastra dhe të thjeshta, pa komplikime dhe përzjerje.
- Konsumi i vezës është vendosur në 4 ditë të javës, duke pasur parasysh përbërjen e saj me elemente ushqyese si kolina, vitamina D dhe luteina-zeaksantina, të cilët janë të pazëvendësueshëm për një fëmijë. Përbërja e pjesës tjetër të ushqimit është mjaft e kufizuar në kolesterol, kështu që konsumi i shpeshtë i vezës nuk përbën shqetësim, pasi sasia totale në ditë nuk i kalon 230mg – me rekomandimin në total <300mg/ditë. Për më tepër, fëmijët kanë nevojë për më shumë kolesterol për peshën e tyre, krahasuar me të rriturit.
- Gjatë dy viteve të para të jetës, ushqimi nuk duhet të jetë tepër i varfër ose tepër i pasur në yndyrë, për këtë kemi zgjedhur produkte bulmeti me 2% yndyrë. Ndërsa përqindja totale e yndyrave është midis 30-40% të kalorive ditore. Konsumi me i ulët i yndyrave në total mund të rrezikojë marrjen e mjaftueshme dhe përthithjen e disa vitaminave dhe mineraleve.
- Vaji i ullirit është yndyra kryesore e ushqimit ditor të fëmijëve, në mënyrë që të përftojë acidet lyrore esenciale të tij, polifenolet dhe antioksidantët që forcojnë imunitetin e fëmijëve dhe paraprijnë për një shëndet kardiovaskular më të mirë, krahasuar me konsumin e yndyrave të ngurta si gjalpi. Zëvendësimi i gjalpit me vaj ulliri është vendosur për të kufizuar marrjen e yndyrave të ngurta dhe të kolesterolit që ai përmban, duke i dhënë hapësirë konsumit më të shpeshtë të vezës. Studimet tregojnë se konsumi i vajit të ullirit nga fëmijët mund të shërbejë si parandalues për shfaqjen e obezitetit. Mbi të gjitha, është mënyrë për t'i edukuar zgjedhjet e fëmijëve edhe në moshë më të rritur.
- Sheqeri i shtuar nuk kalon 10% të kalorive ditore, pasi konsumi më i lartë mund të kompromentojë marrjen e lëndëve të tjera ushqyese.
- Në rajonin e Evropës, mungesa e vitaminës A është më e përhapur, për këtë arsye i është dhënë rëndësi e veçantë marrjes së saj nga ushqime si karrota dhe pjeperi (kur ky i fundit është në stinë).
- Në menu përfshihen shpesh agrumet, për të siguruar marrjen e mjaftueshme të vitaminës C dhe acidit folik, elemente ushqyese me rol të veçantë në rritje, në përthithjen e hekurit (vitamina C) dhe në formimin e ruazave të kuqe (acidi folik).
- Mungesa e hekurit te foshnjat është mjaft e përhapur dhe rezulton në pasoja serioze për shëndetin. Parandalimi i anemisë si pasojë e mungesës së hekurit ka qenë prioritet në hartimin e vakteve. Kjo është arsyeja e përdorimit të përditshëm të mishit të kuq dhe të mishit të pulës, të zëvendësuar me legume ose fasule. Prania e një sasive sado të vogël e mishit në një vakt, favorizon përthithjen e hekurit që përmbajnë ushqimet e tjera bimore si psh: spinaqi, patatet, bizelet etj., “në saje të faktorit të mishit”.
- Mungesa e peshkut në dietën e popullatës së Kosovës dhe pamundësia për ta vendosur në menu nuk e favorizon marrjen e mjaftueshme të yndyrave esenciale Omega 3. Për këtë arsye, menuja është pasuruar me fara lini dhe arra, si një burim bimor i pasur në yndyrna Omega 3.

## NEVOJAT USHQIMORE PËR FËMIJË

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen nevojat kalorike ditore për grupmoshat: 6-12 muaj; 1-3 vjeç; 4-6 vjeç (në kllapa pasqyrohet vlera kalorike e ushqimit që duhet ofruar në kopsht, përkatësisht për grupmoshat e lartpërmendura).

*“Përcaktimi i kalorive dhe lëndëve makro dhe mikroushqyese shtesë për moshën 6-12 muaj (ku është e vështirë të llogaritet sasia e qumështit të gjirit që foshnja konsumon në shtëpi), është realizuar në bazë të rekomandimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë – referuar rajonit të Evropës. Përcaktimi i kalorive dhe lëndëve ushqyese për moshat 1-6 vjeç është realizuar në bazë të udhëzimeve të Autoritetit Ndërkombëtar të Sigurisë së Ushqimit - “EFSA” 2019, Shoqatës Amerikane të Pediatriisë dhe Akademisë Nacionale të Dietologjisë (të Amerikës)”*

NEVOJAT USHQIMORE PËR FËMIJË			
	6-12 muaj	1-3 vjeç	4-6 vjeç
<b>Energji (kcal)</b>	694 (250-450)	1200 (1000)	1600 (1300)
<b>Karbohidrate (gr)</b>	95 (38-68)	150 (110)	210 (145)
<b>Proteina (gr)</b>	11 (7-11)	25 (18)	35 (25)
<b>Yndyrna (gr)</b>	30 (8-15)	33 (23)	47 (23)
<b>Hekur (mg)</b>	11 (4)	7 (5)	10 (7)
<b>Kalcium (mg)</b>	260 (200)	700 (500)	1000 (700)
<b>Kolesterol (mg)</b>	E papërcaktuar	<300 (230)	<300 (230)
<b>Fibra bimore (gr)</b>	E papërcaktuar	19 (12)	25 (18)
<b>Ujë gjithsej (ml)</b>	0,6	1,3	1,6

*(WHO – Vlerësime të përafërta sipas moshës të energjisë në MJ (kcal)/ditë që kërkohen nga ushqimet plotësuese në vende të industrializuara dhe në zhvillim, duke supozuar sasi mesatare të qumështit të gjirit)*



## NEVOJAT USHQIMORE TË FËMIJËVE NË INSTITUCIONET E KUJDESIT DITOR

Fëmijët që frekuentojnë çerdhet dhe kopshtet shtetërore dhe private duhet të kenë akses në ushqim të mjaftueshëm, të sigurt dhe të ushqyeshëm që të plotësojë nevojat e tyre individuale në energji dhe lëndë ushqyese. Në institucionet e kujdesit për fëmijë me kohë të plotë duhet të ofrohet të paktën 2/3 e nevojave ditore në lëndë makro dhe mikroushqyese.

## INSTITUCIONET DUHET TË NDJEKIN RIGOROZISHT KËRKESAT E MËPOSHTME:

- Të marrin me shkrim nga prindërit udhëzime të ushqyerjes për të gjithë fëmijët nën moshën 1 vjeç;
- Të marrin me shkrim nga prindërit nevojat e veçanta ushqimore për fëmijët në raste specifike. Pijet apo ushqimi i dorëzuar nga prindi duhet të ketë etiketë të qartë me emrin e fëmijës dhe datën në të cilën ushqimi u dërgua në kopsht/çerdhe;
- Ushqimi duhet të ruhet në mënyrë të sigurtë dhe të duhur për të ruajtur vlerat e tij ushqyese dhe për të minimizuar rrezikun e kontaminimit apo prishjes;
- Çdo kopsht/çerdhe duhet të ketë të paraqitur në mënyrë shumë të dukshme në kuzhinë dhe në vendin ku shërbehet ushqimi një listë me emrat e fëmijëve që kanë alergji ushqimore. Menutë javore duhet të paraqiten në vende të dukshme për prindërit dhe duhet të ndërrohen çdo muaj, të përditësuara.



## MOSHA 6-12 MUAJ

## FILLIMI I USHQIMIT SOLID – KRAHAS QUMËSHTIT TË GJIRIT OSE FORMULËS

Gjatë periudhës së tranzicionit nga ushqyerja me gji në ushqim të ngurtë, qumështi i gjirit (ose ai me formulë) mbetet ushqimi kryesor deri në moshën 1 vjeç. Në këtë fazë, ushqimi i zakonshëm është plotësues. Roli i tij është të plotësojë mjaftueshëm me hekur dhe kalori për një shëndet të mirë dhe zhvillim optimal, t'i i prezantojë fëmijës shije dhe substanca të reja dhe t'i zhvillojë atij aftësitë e bluarjes, përtypjes dhe tretjes së ushqimeve të ngurta.

Midis 4-6 muaj, sipas Shoqatës Amerikane të Pediatriës (AAP), është periudha në të cilën mund të fillohet ushqimi i zakonshëm. Menutë janë hartuar specifikisht për moshat 6-8 muaj, 8-10 muaj dhe 10-12 muaj, duke marrë parasysh nevojat specifike të secilës prej tyre.

*\*Qumështi i lopës, i pamodifikuar, nuk rekomandohet në këtë moshë për shkak se lidhet me hemorragji të aparatit tretës dhe anemi. Ai mund të përdoret me pakicë në përgatitjen e disa ushqimeve si kek, puding, supë, omëletë, etj. Midis vitit të parë dhe të dytë, mund të kalohet nga qumështi i gjirit në atë të lopës, me yndyrë të reduktuar. Por duhet të tregohet kujdes me reduktimin e tepërt të yndyrës, për këtë arsye qumështi që këshillohet në menu është me përmbajtje 2% yndyrë.*



Meqenëse qumështi i gjirit nuk mbulon dot nevojat e foshnjeve në hekur, pas muajit të 6-të përfshirja e drithërave të pasuruara me hekur, të përshtatshme për moshën përkatëse rekomandohet gjerësisht. Gjithashtu, në muajin e 6-të këshillohet të fillojë mishi, lëngu i kockave, perimet dhe legumet për të parandaluar aneminë.

Konsumi i lëngjeve të shtrydhura nuk kalon 120ml në ditë për fëmijët latantë dhe 240ml për moshat 4-6 vjeç dhe është zgjedhur i pasur në vitaminë C ose A, të dyja thelbësore për zhvillimin dhe imunitetin.

Kripa nuk përfshihet në ushqimin e fëmijëve më të vegjel se 12 muaj, ndërsa sheqeri është me kufizim.

Deri 6 muaj, përbërja e ushqimit është krejtësisht e lëngshme, ndërsa pas 8 muajve, sipas rekomandimeve të fundit, përbërja fillon të jetë më e trashë në mënyrë që fëmija të fillojë të zhvillojë aftësinë e bluarjes.

Fillimi i vezës praktikohet me të verdhën në moshën 6 muajshe dhe të plotë në moshën 10 muajshe.

Mishi i pasur në hekur dhe drithëra të pasuruara me hekur duhet të jenë ushqimet e para plotësuese. Vendosja e një larmie ushqimesh të shëndetshme duhet të jetë prioritet në vazhdim pas fillimit të ushqimit solid.

Të ofrohet teksturë e ndryshme për moshën 6-12 vjeç (e lëngët, pure, e shtypur, e bluar, e butë).

Foshnjat deri 12 muaj të ushqehen sipas kërkesës në varësi të oreksit dhe ngopjes së tyre. Pas 1 viti, ofroni sasinë e programuar për fëmijën.

## ZHVILLIMI I FOSHNJËS DHE USHQIMET E REKOMANDUARA

Meqenëse çdo fazë e zhvillimit ndërtohet mbi atë të shkuarën, ushqimet e një faze më të hershme përfshihen në të gjitha fazat që pasojnë.

ZHVILLIMI I FOSHNJËS DHE USHQIMET E REKOMANDUARA		
Mosha	Aftësia e të ngrënit	Ushqime të përshtatshme
6-8 muaj	Refleksi i nxjerrjes së ushqimit zbehet krejtësisht, zhvillohet aftësia e gëlltitjes së një ushqimi jo të lëngshëm. Shfaq dëshirë për të ngrënë ushqim duke hapur gojën përpara tij dhe duke ndjekur me sy ushqimin e më të rriturve. Tregon ngopjen duke larguar kokën. Qëndron ulur, me mbështetje. Fillon veprimin e bluarjes. Kap sende me pëllëmbën e dorës.	Fillohen drithërat e pasuruara në hekur, të përziera me qumësht gjiri ose formulë, ose ujë. Fillohen mishi i bluar, legume, perimet dhe frutat. Fillohen perimet dhe frutat me përbërje më të trashë. Fillohen lëngjet e frutave të shtrydhur, të holluar me ujë, me gotë (jo me biberon).
8-10 muaj	Fillon të mbajë shishen e biberonit Zgjatet të arrijë të kapi lugën dhe ushqimin. Ulet pa mbështetje.	Fillohet buka dhe drithërat e zakonshme. Fillohet kosi. Fillohen copëza të buta, të perimeve të gatuar. Fillohen sasi të vogla të mishit të copëtuar hollë, peshkut, djathëit, vezët, dhe legume të shtypura.
10-12 muaj	Komandon lugën, por akoma i derdhet ushqimi.	Shtohet larmia. Gradualisht rritet sasia.



## MOSHA MBI 2 VJEÇ

Fëmijë të ndryshëm kanë nevojë për sasi të ndryshme ushqimi. Zakonisht, fëmijët më të vegjël kanë nevojë për më pak sasi sesa fëmijët më të rritur. Gjithsesi, filloni me një racion të vogël dhe shtoni sipas kërkesës.

"Fëmijët e moshave 2-3 vjeç duhet të konsumojnë 2 gota qumësht ose nënprodukte të tij çdo ditë, ndërsa fëmijët e moshave 4-6 vjeç duhet të konsumojnë 2½ gota qumësht çdo ditë. Mbi moshën 2 vjeç qumështi duhet të jetë i reduktuar në yndyrë, 2%."



UDHËZUES MBI RACIONET E USHQIMEVE PËR FËMIJËT	
Ushqimet	Racionet
Perime/fruta	½ kupë (120ml) perime të freskta ose të ngrira ose 100% lëng i shtrydhur 1 kupë (240ml) lëng perimesh ose gjethe jeshile ose sallatë 1 frut mesatar
Drithëra	1 fetë bukë integrale (40gr) 40gr pite (kulaç) ½ kupë (125ml) oriz, makarona, bullgur, kuskus 30gr tërshërë ose drithëra pa sheqer
Bulmet	1 gotë qumësht ose 180ml kos 45gr djathë
Mish dhe alternativa	75gr peshk, pulë, ose mish pa dhjamë ¾ kupë (175ml) fasule të gatuar ose thjerrza ose qiçra 2 vezë



## SASIA E USHQIMIT SIPAS VAKTIT, MOSHËS, GRUPIT TË USHQIMIT

### MËNGJESI

Grupi i ushqimeve	GRUPMOSHA		
	1-2 vjeç	3-5 vjeç	>6 vjeç
<b>Qumësht</b>	½ kupë*	¾ kupë	1 kupë
<b>Frut ose Perime</b>	¼ kupë	½ kupë	½ kupë
<b>Drithëra</b>	15gr bukë ose ¼ kupë drithëra të gatuar	30gr bukë ose ½ kupë drithëra të gatuar	30gr bukë ose ¾ kupë drithëra të gatuar

\*1 kupë = 240ml

### DREKA

Grupi i ushqimeve	GRUPMOSHA		
	1-2 vjeç	3-5 vjeç	>6 vjeç
<b>Frut &amp; Perime</b>	½ kupë	¾ kupë	1 kupë
<b>Mish dhe alternativa</b>	60gr	90gr	90gr
<b>Drithëra</b>	15gr bukë ose ½ kupë drithëra të gatuar	30gr bukë + 1 kupë drithëra të gatuar	30gr + bukë ose ½ kupë drithëra të gatuar
<b>Yndyrna</b>	2	2	3

\*1 kupë = 240ml

### ZAMRA

Të zgjidhen 2 nga 5 përbërësit

Grupi i ushqimeve	GRUPMOSHA		
	1-2 vjeç	3-5 vjeç	>6 vjeç
<b>Qumësht</b>	½ kupë *	½ kupë	1 kupë
<b>Frut &amp; Perime</b>	½ kupë	¾ kupë	1 kupë
<b>Mish dhe alternativa</b>	15gr	15gr	30gr
<b>Drithëra</b>	15gr bukë ose ¼ kupë drithëra të gatuar	15gr bukë ose ½ kupë drithëra të gatuar	30gr bukë ose ½ kupë drithëra të gatuar

\*1 kupë = 240ml

## KRITERET PËR NJË MENU TË USHQYESHME

Vendosni shenjen "check" për çdo kërkesë të plotësuar

Kriteret	PO	JO
1. Gjysma e drithërave të servitura janë integrale	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2. Perime me ngjyrë jeshile të theksuar (brokoli, spinaqi, sallata jeshile, lakra jeshile) dhe perime ose frut me ngjyrë portokalli (kungull, karrotë, patate e ëmbël, kajsi, pjeshkë, pjepër, nektarina) serviren pjesen më të madhe të kohës.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3. Fasulet dhe thjerrzat shërbehen të paktën 1 herë në javë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4. Ushqime me dendesi të lartë në kalori, yndyrë, kripë dhe sheqer si biskota, kos frutash, akullore, ushqime të skuqura dhe sallame/salçiçe, shërbehen shumë rrallë ose fare.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5. Menuja përfshin ushqime me: ngjyra të ndryshme forma të ndryshme (të griira, me fije, kubike, në madhësi të ndryshme) tekstura dhe temperatura të ndryshme (të gatuar, të gjallë, krokant, të bute, të lëngët).	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6. Menuja përfshin: Ushqime lehtësisht të ngrënshme që përshtaten me preferencat e tyre kulturore. Disa ushqime të tipit "finger food".	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7. Menuja përfshin ushqime të sigurta: Nën moshën 3 vjeç duhet të evitohen të gjitha ushqimet që përbëjnë rrezik mbytjeje (kokrra të vogla si kikirika, bajame, fara, copëza të forta perimesh) Kokoshkat dhe karamelat përjashtohen nga menuja.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8. Menuja përjashton ushqime që ngjiten, ushqime të ëmbla dhe fruta si ato të tharat, të cilat ngjiten në gojë dhe nxisin karies.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9. Menuja përfshin: 10-15gr/ditë mish, vezë ose pulë për moshat 6-18 muaj 30-60gr mish, vezë, pulë për moshat 1 – 3 vjeç, 2-3 herë në javë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
10. Menuja ofron një raport të shëndetshëm midis yndyrnave omega 3/omega 6.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
11. Menuja kufizon lëngjet e shtrydhura në më pak se 120ml në ditë ose fare.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

## KRITERET PËR NJË MJEDIS TË SHËNDETSHËM TË TË USHQYERIT

Vendosni shenjen "check" për çdo kërkesë të plotësuar

Kriteret	PO	JO
1. Ushqimi të shërbehet sa më afër mënyrës familjare, ku fëmija zgjedh vetë sasinë që dëshiron.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2. Ushqimi duhet të serviret në enë të posaçme për fëmijë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3. Të largohen lodrat, TV, librat dhe gjithçka që tërheq vëmendjen nga ushqimi.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4. Fëmijët duhet të kenë kohën e mjaftueshme për t'u ushqyer, minimumi 30 minuta për vaktin kryesor dhe 20 minuta për vaktet midis.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5. Ushqimi nuk duhet të shërbejë as si shpërblim, e as si ndëshkim.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6. Lejoni ndarjen e përgjegjësisë ku fëmijët janë përgjegjës për sasinë e konsumuar. Personeli duhet të evitojë frazat "mbaroje pjatën", "ha dhe një kafshatë", ose "të lumtë që e mbarove pjatën"	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7. Për fëmijët e moshës 1 vjeç, të cilët tregojnë gjithë shenjat e zhvillimit të duhur, pijet duhet të shërbehen në gota pa kapak dhe jo biberon.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8. Personeli duhet të konsumojë ushqim së bashku me fëmijët. Të paktën një pjesëtar i personelit duhet të ulet dhe të hajë të njejtin ushqim me fëmijët. Personeli nuk duhet të sjellë ushqim nga jashtë në kohën e vaktit, nuk duhet të konsumojë ushqim jashtë orarit të vakteve dhe nuk duhet të konsumojë ushqim të pashëndetshëm në sy të fëmijëve.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9. Personeli duhet të përfshijë aktivitete mbi ushqyerjen e shëndetshme dhe mesazhet përkatëse në programin edukativ (p.sh. vizatim të fruta/perimeve, praktika të mbjelljes, përgatitje brumi etj)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
10. Personeli duhet të përditësohet për burimet mbi ushqyerjen e shëndetshme për fëmijët dhe familjet.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
11. Ushqimi në festa duhet të jetë i përputhshëm me parimet e ushqyerjes së shëndetshme mbi të cilat është ngritur menuja.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
12. Fëmijët duhet të inkurajohen të ushqehen vetë dhe jo t'i ushqejnë edukatorët.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

## PARIMET E USHQYERJES SË SHËNDETSHME PËR FËMIJET E MOSHËS 6 MUAJ – 3 VJEÇ

<b>Brumrat Baza e ushqimit</b>	Preferoni drithëra të plotë (me krunde); Preferoni variantet pa yndyrë, pa kripë e pa sheqer të shtuar; Evitoni skuqjen; Konsumoni patatet si pjesë e një diete të balancuar; jo me shpesh se 2 herë/javë perime me amidon.
<b>Fruta 1-2/ditë</b>	Konsumoni larmi frutash; Preferoni fruta sezonale dhe lokal; Disa komunitete theksojnë marrjen e frutave të pyllit; Jo reçel; Holloni lëngjet e shtrydhura me ujë; Mos u shtoni sheqer lëngjeve të shtrydhura.
<b>Perime Te paktën 3 copë/ditë</b>	Prodhime lokale dhe sezonale; Larmi midis llojeve të ndryshme: të paktën 2 herë/javë perime jeshile, 2 herë/javë perime portokalli; Evitoni copa perimesh të forta.
<b>Bulmeti</b>	Qumështi, kosi, me yndyrë të reduktuar për moshat mbi 2 vjeç; Të paktën 2 racione në ditë; 1 gotë qumësht; 180ml kos; 45gr djathë.
<b>Yndyrna</b>	Të evitohen yndyrnat e ngurta dhe yndyrnat transdite 1-3 lugë të vogla.
<b>Mishi/pula/vezë/ djathë</b>	Nga 10-70gr/ditë; të zëvendësohet mishi me vezë, fasule, peshk; të konsumohet peshk 1-2/javë; të evitohet mishi i përpunuar.
<b>Sheqeri</b>	Të kufizohet sheqeri i shtuar; Kujdes nga sheqeri i fshehur.
<b>Kripa</b>	Të përdoret rrallë ose fare, të përdoret e jodizuar.

## PËRCAKTIMI I CILËSISË SË USHQIMIT

- Të ndërpritet ushqimi i bluar në forme pureje pas 10 muajve;
- Qumështi duhet të jetë me yndyrë të reduktuar për moshën mbi 2 vjeç;
- Drithërat e mëngjesit duhet të jenë integrale, me më shumë se 4gr fibra për racion, më pak se 2gr yndyrna të ngopura për racion, më pak se 240mg kripë për racion dhe pa sheqer të shtuar;
- Mishi duhet të jetë pa dhjamë dhe i butë;
- Mishi i grirë duhet të jetë cilësor, pa dell, lëkura dhe dhjamë, nga pjesë e zgjedhur e viçit;
- Vaji i ullirit duhet të jetë ekstra i virgjër në sallata dhe i virgjër në gatim;
- Gjalpi duhet të jetë në mënyrë kategorike 100% shtazor dhe jo margarinë!

## NEVOJAT USHQIMORE PËR FËMIJËT ME ÇRREGULLIME TË SPEKTRIT TË AUTIZMIT

Sikurse rezulton nga dhjetëra studime, fëmijët me çrregullime të spektrit autik paraqesin zgjedhje të kufizuara të ushqimit, fenomen që mund të shkaktojë deficienca ushqimore. Shumë prinder besojnë se një dietë që eliminon kazeinen që gjendet te bulmeti dhe glutenin që gjendet te gruri, thekra, elbi dhe tershera, ndikon pozitivisht në ecurinë e zhvillimit të tyre, por ende nuk ka asnjë udhëzim zyrtar aprovues për këto ndërhyrje dietetike. Fëmijët me autizëm duhet të konsumojnë të njejtin ushqim si bashkëmohatarët e tyre me zhvillim normal. Në rastet që kjo bëhet e vështirë, nevojitet bashkëpunimi me një dietolog të trajnuar në këshillimin konjitiv, psikolog dhe prindin, për të mësuar teknikat e nevojshme që do të ndihmonin në pranueshmërinë e ushqimit të larmishëm dhe të shëndetshëm. Nëse vërehet që fëmijë të tillë paraqesin njëanshmëri në ushqim dhe refuzim, të kërkohet ndihma e prindit dhe specialistit të sjelljes për rastet përkatëse (Zimmer M H, 2012).



## MENUTË JAVORE TË FOSHNJAVE SIPAS GRUPMOSHAVE PËR STINËT (VJESHTË-DIMËR)

### MENU JAVORE PËR FOSHNJË 6-8 MUAJ

	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte
<b>MËNGJES</b>	1 lugë të madhe pure mollë të zier 3 lugë të mëdha drithëra të pasuruara me hekur, të përziera me qumësht formulë	1 lugë të madhe pure dardhë të zier 3 lugë të mëdha drithëra të pasuruara me hekur, të përziera me qumësht formulë	1 lugë të madhe banane të shtypur 3 lugë të mëdha drithëra të pasuruara me hekur, të përziera me qumësht formulë	1 lugë të madhe pure mollë të zier 3 lugë të mëdha drithëra të pasuruara me hekur, të përziera me qumësht formulë	1 lugë të madhe pure mollë të zier 3 lugë të mëdha drithëra te pasuruara me hekur, të përziera me qumësht formulë
	<b>PËRBËRËSIT</b>				
	¼ mollë	¼ mollë	¼ mollë	¼ mollë	¼ mollë
	10gr drithëra për fëmijë	10gr drithëra për fëmijë	10gr drithëra për fëmijë	10gr drithëra për fëmijë	10gr drithëra për fëmijë
	60ml qumësht formulë	60ml qumësht formulë	60ml qumësht formulë	60ml qumësht formulë	60ml qumësht formulë
<b>PARADITE</b>	120ml qumësht formulë				
<b>DREKE</b>	Supë me bizele, karrota, mish pule* (të bluara deri sa të bëhen krem i hollë)	Supë me thjerrza, pak qepë, selino, karrotë, lëng pule (të bluara deri sa të formohet krem i hollë)	Supë me patate, kungull, spinaq, mish pulë (të bluara)	Supë me fasule, qepë, karrotë, mish të kuq (të bluara)	Supë me brokoli ose lulëlakër, patate, karrotë (të bluara)
	<b>PËRBËRËSIT</b>				
	40gr bizele	25gr thjerrza	20gr patate	25gr fasule*	20gr mish pule
	10gr karrotë	2gr selino	10gr kungull jeshil	1/8 qepë	Pak lëng pule
	20gr mish viçi	¼ karrotë	20gr mish pule	¼ karrotë	30gr brokoli ose lulëlakër
	1 lugë (5gr) vaj ulliri	1 kupë 1 lugë të vogël (5gr) vaj ulliri lëng pule	1 lugë të vogël (5gr) vaj ulliri	20gr mish viçi 1 lugë të vogël (5gr) vaj ulliri	30gr patate ¼ karrotë 20gr mish pule 1 lugë (5gr) vaj ulliri
<b>ZEMER</b>	Pure frutash me lëng karrotë ose portokalli				
	<b>PËRBËRËSIT</b>				
	60ml lëng karrotë 60gr frut të bluar (mollë, dardhë ose banane)				
	Vlerat ushyese ditore (vetëm nga ushqimi, pa llogaritur qumështin)				
	Energji: 255kcal	Karbohidrate: 37gr	Yndyrna: 9,3gr	Proteina: 12,9gr	

**\*Shënime:**

Fillimi i ushqimeve solide varion nga fëmija në fëmijë, në varësi të gadishmërisë së tij fizike dhe tolerancës. Ushqimet duhet të vendosen 1 lloj çdo dy-tre ditë për të konstatuar ndonjë alergji të mundshme.

Fasulet të lihen një natë në ujë të pijshëm dhe ky ujë të derdhet para se të gatohen.

Të gjitha ushqimet duhet të kenë konsistencë të lëngët, pa asnjë copëz të fortë.

Të mbikqyren fëmijët gjatë gjithë kohës së ushqyerjes.

**MENU JAVORE PËR FOSHNIJE 8-10 MUAJ**

	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte
<b>MËNGJES</b>	Kaçamak me 15gr djathë të bardhë & vaj ulliri Karrotë pure ose lëng	Pure me ½ mollë	açamak me 15gr djathë te bardhë & vaj ulliri Banane e shtypur	Pure me ½ mollë Karrotë pure ose lëng	Kaçamak me djathë & gjalpë Karrotë pure ose lëng
<b>PËRBËRËSIT</b>					
	20gr miell misri 15gr djathë të bardhë 1 lugë të vogël vaj ulliri ½ karrotë të zier, të bluar me lëngun e vet	60ml kos 15gr bukë gruri	Banane e shtypur 20gr miell misri 15gr djathë të bardhë 1 lugë të vogël gjalpë 30gr banane	60ml kos 15gr bukë gruri 5gr gjalpë 1 karrotë	20gr miell misri 15gr djathë të bardhë 5gr gjalpë 1 karrotë
<b>PARADITE</b>	180ml qumësht formulë ose qumësht gjiri				
<b>DREKE</b>	Supë e lëngët: bizele, karrotë, mish* viçi (të bluara deri sa të bëhen krem)	Supë me thjerrza, pak qepë, selino, karrotë lëng pulë – të bluara deri sa të formohet krem i hollë	Supë me patate, bizele, karrota, mish pule - të bluara	Supë me fasule, qepë, karrotë, mish të kuq - të bluara	Supë me brokoli ose lulëlakër, patate, karrotë, qumësht
<b>PËRBËRËSIT</b>					
